



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1133 / Prot. 3

Tiranë, më 23/11/2016

REKOMANDIM

Nr. 34, datë 23/11/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Osumi Travel" Sh.p.k, Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 230, datë 21.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Osumi Travel" (Nipt K11812002V), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Osumi Travel" ushtron aktivitetin në fushën e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe për këtë qëllim mbledh dhe përpunon të dhëna personale të klientëve dhe të punëmarrësve.

1. Kontrolluesi përpunon të dhëna për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Klientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë "klientë" kontrolluesi përpunon të dhënat emër, mbiemër dhe nr. pasaporte. Për kategorinë "punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna të identifikimit (emër, mbiemër, numrin e sigurimit shoqëror, numrin personal të identifikimit), nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore. Të dhënat përpunohen elektronikisht nga operatorët e kontrolluesit, në formatin Excel dhe manualisht në lista të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve.

Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se nuk është përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

Realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

2. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, grupi i hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi “*Osumi Travel*” nuk i informon subjektet e të dhënave personale “Klientë”, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu në faqen e internetit të kontrolluesit www.osumitravel.al nuk është i parashikuar informimi nëpërmjet rubrikës “*Politikat e privatësisë*”. Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “*Politikat e privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “*Politikave të privatësisë*” përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

3. Kontrolluesi ka vendosur në ambientet e brendshme kamera vëzhgim regjistrimi CCTV, me qëllim garantimin e sigurisë. Nëpërmjet sistemit të video-survejitimit mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave punonjës dhe klientë. Kontrolluesi ka në administrim 3 kamera nga të cilat 2 (dy) janë të vendosura në ambientet e brendshme dhe 1 (një) në fasadën e jashtme ku ushtron aktivitetin. Regjistrimet fshihen automatikisht në pajisjen DVR pasi ruhen për një afat 7 (shtatë) ditor dhe mund të aksesohen vetëm në prani të administratorit.

Kontrolluesi nuk ka realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejitimit në hyrje të ambienteve, ku ushtron veprimtarinë e tij.

4. Kontrolluesi nuk ka hartuar një “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, u caktua ora 10.30 e datës 15/11/2016 për zhvillimin e seancës dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit “*Osumi Travel*”, gjatë seancës dëgjimore, kanë dokumentuar disa nga masat e marra në kuadër të konstatimeve të grupit të kontrollit, si Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave (në zbatim të nenit 27 të ligjit), plotësimi i Formularit të Njoftimit (në zbatim të nenit 21 të ligjit), si dhe vendosja e tabelës informuese për sistemin e video-survejitimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neni 31, pika 1. germa a/1.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Osumi Travel", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:
 - Të marrë masa për të përfshirë në faqen e tij të Internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
 - Të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese për sistemin e video-vëzhgimit, sipas modelit standard të tabelës informuese të përcaktuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
2. Kontrolluesi "Osumi Travel", në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 15 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 23.11.2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI